



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 22/ 2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtuar nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) me seli në Graçanicë, kundër subjektit poilitik Lista Srpska (LS), me seli në Graçanicë, që ka të bëjë me para fushatën zgjedhore, për zgjedhjet e Parakohëshme për Kuvend të Kosovës në seancën e panelit të mbajtur me 02.06.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**HEDHET si e palejuar** ankesa e subjektit politik “Samostalna Liberalna Stranka” (SLS) me seli në Graçanicë,

#### Arsyetim

PZAP-i, me datë 31.05.2017 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) me seli në Graçanicë, në të cilën pretendohet se në natën në mes të datës 30-31.05.2017, pas orës 00-00, një grup prej rreth 70 aktivistësh nga Lista Srpska, kanë sulmuar aktivistët e subjektit politik SLS, pa ndonjë arsyet.

Incidenti ka ndodhur para bilbordit, tek muri i manastirit në qendër të Graçanicës.

Parashtruesi i ankesës më tej thekson se në vendin e ngjarjes kishte qenë prezent edhe Shërbimi Policor i cili ishte njoftuar për të gjitha detajet, ku si rezultat i kësaj mosmarrveshje prokurori i shtetit për shkak të seriozitetit të situatës, kishte marr një vendim që të gjitha aktivitetet e tillë apo të ngjashme, të pezullohen deri në një njoftimin e radhës.

Përfaqësuesit e subjektit politik SLS, pas këtij incidenti kishin kërkuar të takohen me KKZ në Graçanicë, me qëllim që të arrijnë një marrveshje që në 4 bilbordet që gjenden në Graçanicë, për të cilat askush nuk posedon dokumentacion të duhur, të ndahen në shfrytëzim për të gjitha partitë politike. Mirëpo, sipas pretendimeve ankimore përfaqësuesit e Lista Srpska nuk kanë dëshiruar të bënin këtë marrëveshje.

SLS kërkojnë që ankesa e tyre të shqyrtohet në një afat sa më të shkurtër dhe të merret vendimi i drejtë i cili do ta kishte për qëllim trajtimin e barabartë e të gjitha subjekteve politike në territorin e Komunës së Graçanicës.

Lidhur me këtë PZAP-i e informoi Policinë e Kosovës për rastin në fjalë dhe kërkoi që ta informoj lidhur me të, ku në raportin e pranuar nga PZAP-i, thuhet se me daten 30.05.2017, rreth orës 22:30 është raportuar se situata në mes partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje është e tensionuar, për shkak të akuzimit të usurpimit të billbordeve të cilat gjenden në Graçanicë.

Nga të dy subjektet politike ka pasur akuza për njëra tjetrën, pasi që nga asnjë kompani për shfrytezimin e atyre billbordeve nuk posedojnë kontratë valide, dhe si e tillëmund të shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga të gjitha subjektet politike që të vendosin material reklamues.

Subjekti politik "Lista Srpska" sipas raportit policor, ka pretenduar se i posedon të gjitha dokumentet valide për shfrytezimin e atyre billbordeve dhe se, subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka kane pasur ballafaqim lidhur me billbordin qe gjendet tek muri i Manastirit në Graçanicë.

Mirëpo pasi që Policia ka verejt një situatë të tensionuar ka ndërhyrë në mes dhe me urdher të Prokurorit kujdestar, dhe ju ka ndaluar perkohsisht të gjitha palëve për shfrytezimin të këtyre billbordeve duke i udhezuar palët që të drejtohen në KQZ për sanimin e kësaj gjendjeje Policia ka zbatuar urdhërin e Prokurorit për te evituar konfliktin e mundeshëm fizik në mes të rreth 70 anetarëve të subjektit politik LS dhe 10-15 anetarëve të subjektit politik SLS. Diku rreth orës 01:30 të dates 31.05.2017 është bërë shpërndarja e aktivisteve të partive politike.

PZAP-i, pas pranimit të ankesës në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoj Lista Serbska me datën 31.05.2017, për ankesën që është bërë ndaj saj duke i dhënë mundësin për tu përgjigjur.

Në përgjigjen e subjektit politik LS, thuhet se subjekti politik SLS, duke i shkelur dispozitat ligjore për fillimin e fushatës zgjedhore, para afatit (në ora 23:40), dhe duke mos e poseduar dokumentacionin i cili do t'i uje drejtë legitime për përdorimin të billbordit, ka vendosur poster me llogo të SLS-së, në billbordet e uzurpuara. Sipas tyre ky gjest ka shkaktuar revoltë tek simpatizuesit e subjektit politik "Srpska Lista", të cilët më pas kanë hequr posterin nga billbordi.

Më tej në përgjigje theksojnë se subjekti Politik SLS-ta, me kohë ka marrë lejen e nevojshme dhe ka paguar të gjitha taksat për përdorimin e këtyr 4 billbordeve, mes të tjerash edhe billbordin e kontestuar, përpala murit të manastirit në qendër të Graçanicës.

E gjithë kjo ngjarje është përcjellë me një sjellje tolerante dhe të përmbajtur të pjesëtarëve dhe simpatizuesve të subjektit politik SLS-ta.

Më tutje, LS-ja e kundërshton pretendimin ankimore të paraqitur në ankesë, ku thuhet se për 4 billborde në Graçanicë askush nuk posedon dokumentacionin e duhur, sipas tyre ata posedojnë dokumentacion për 4-rë billborde në Graçanicë (3 billborde në pronësi të komunës së Graçanicës dhe 1 në pronësi të Dioqezës së Rashkës dhe Prizrenit cili i jep të drejtë që në mënyrë legitime të reklamoje lidhur me zgjedhjet e ardhshme.

Si dëshmi pala në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur dokumentacionin për taksat e paguara për lejen e shfrytëzimit të billbordit, si dhe vërtetimin e të drejtës legitime për përdorimin billbordeve në Graçanicë, tëcilën e ka interpretuar pozitivisht KQZ-ja më datë 31.05.2017.

Duke i vlerësuar të gjitha ato që janë thënë dhe arsyetuar, kërkojnë nga PZAP-i që, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe materialeve-dëshmive të bashkangjitura, ankesën e Subjekti Politik SLS të refuzojë si pabazuar.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**Ankesë është e pa lejuar**

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se ankesë është e palejuar për faktin se shpallja zyrtare e fushatës zgjedhore ka filluar më 31.05.2017 në ora 00:00, ndërsa mosmarrveshja në mes të subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) dhe subjektit politik Lista Srbska (LS), sipas raportit policor

policor ka filluar rrëth orës 22:30, gjë që PZAP-i nuk ka juridikcion që të vendosë ankesat e të cilat kanë të bëjnë me shkeljet para fushatës zgjedhore.

Andaj, mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruesit nuk qëndrojnë dhe se ankesa në këtë fazë është e palejuar për tu parashtruar.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 22/2017 më datën 02.06.2017



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.